

PROFILI SHOQËROR, PROFILI I PËRGJITHSHËM

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në prozë dhe një në tragjedi.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 24 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

MARTIN CAMAJ – Rrungaja në mars

Kërkesat 1-5

Kërkesa 1	C	1 pikë
Kërkesa 2	A	1 pikë
Kërkesa 3	C	1 pikë
Kërkesa 4	A	1 pikë
Kërkesa 5	B	1 pikë

Kërkesa 6 3 pikë

Model përgjigjeje

Fatin e Jerës e bën tragjik shpërfillja e dashurisë së femrës, mentaliteti malësor. Askush nuk i kuptoi përmasat e dhimbjes së saj. Mungesa e komunikimit midis njerëzve, izolimi dhe vetizolimi, ftohtësia, ashpërsia në marrëdhëniet midis dy krahinave.

Ose

Mohimi i dashurisë së saj, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë, është thelbi tragjizmit të saj (i protestës së saj të heshtur e tragjike).

1 pikë Nëse shpjegon qartë thelbin e tragjizmit të Jera.

0 pikë Nëse shpjegon gabim fatin tragjik të Jerës.

1 pikë **Detaje** ku shfaqet tragjikja në fatin e Jerës: *vajza e ndryni zemrën e vet, ...vetëm një prej fisit të tij të ishte ndalë në kambë sa për t'i thanë në të folmen e vrazhdë të Përtejçafës: sa e shemtuet kënge!; Por asnjë për be nuk qëndroi, Jera kish vdekë dalngadalë shumë mote ma parë.*

1 pikë Ilustrime ku shfaqet tragjikja në fatin e njerëzve: *aq ma pak ndaleshin pranë krojeve me pushue e pi ujë..., As synin nuk e çonin nalt me shikue mbi udhë, por asnjë banor i katundit buzë lumit, nuk kishte ma të voglën marrëdhanie me përtejçafasit, rruga pa asnjë vend pushim.*

0 pikë Nëse ilustrimet që gjen nuk i përgjigjen thelbit të pyetjes.

Kërkesa 7 3 pikë

Model përgjigjeje

Po, janë brenda psikologjisë së mjedisit. Ky është një vend i ashpër, i ftohtë, i mbyllur, ku njerëzit pak komunikojnë dhe nuk përpiqen të kuptojnë ndjenjat e njëri-tjetrit, ku dashuria është një tabu dhe nuk preket as me fjalë. Ndaj dhe Jera e dënoi veten me vetmi “*me dhimbën e pjekun në zemër*”. Përderisa askush nuk e kuptoi ajo e zemëruar dhe kryeneçe u mbyll në vetminë e saj.

2 pikë Nëse shpjegon **qartë** pse kryeneçësia e Jerës është brenda psikologjisë së mjedisit.

1 pikë Nëse shpjegon **pjesërisht** pse kryeneçësia e Jerës është brenda psikologjisë së mjedisit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

1 pikë Ilustrimi nga fragmenti. *Jetoi tue këqyrë mbi krena të njerëzve..., , Do të ishte gëzue Jera. Por asnjë për be nuk qëndroi, as Jerës nuk iu dha rasti t’i thotë një njeriu të vetëm nga Përtejçafa se po e këputka malli me folë me njenin sish, ” Çka po të duhet emri im?”.*

Kërkesa 8 1 pikë

Model përgjigjeje

Ky paralelizëm e portretizon vajzën së brendshmi, pasi del në pah instinkti, të cilin ajo nuk e zotëron dot. Në brendësi ka mbetur njerëzore, e ndjeshme, sado që së jashtmi duket e ngurtësuar.

Ose

Ka ngjashmëri mes ringjalljes së natyrës dhe ringjalljes së ndjenjave të harruara, siç është zbutja e acarimit me njerëzit dhe dëshira për jetë.

1 pikë Nëse jep qartë thelbin e përgjigjes së dhënë më sipër.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Kërkesa 9 4 pikë

1 pikë Paragrafi: *Kundro sot....ajo e acartë!*

1 pikë Ironia i drejtohet vetes: *Këqyr, këqyr! – thoshte ajo*. Jeta vazhdon pavarësisht dhembjes së saj.

Figurat:

Antiteza: *hijet-dritat*

Metafora: *lan gurin, ndan katundin*

Epitet: *e acartë*

Përsëritje: *kundro..kundro, kqyr, këqyr*

Enumeracionet: *ndërrimet e stinëve, hijet e dritat, çdo fazë të rritjes së pemëve gjithnduersh, të mollës e të ftonit të fortë.*

Inversioni: *asht ajo e acartë*

Elipsa: *Me një shikim andej* (mungesa e foljes)

2 pikë Nëse gjen dy figura stilistike bashkë me ilustrimet përkatëse.

1 pikë Nëse gjen një figurë stilistike bashkë me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi nuk do të marrë pikë nëse gjen vetëm figurën, por nuk e shoqëron me ilustrimin përkatës.

Kërkesa 10 2 pikë

Model përgjigjeje

Shikimi i babait të Dakut, i kujton edhe një herë si në ëndërr Jerës, të dashurin.

Sytë janë detaji më i fortë, përmes të cilëve kuptojmë *zbraztinë, vetminë* dhe *tretjen përfundimtare* të saj. Është porta e fundit që ajo lë për të hetuar në shpirtin e saj, të tharë tashmë, përpara se të mbyllet nga vdekja. “*Diçkaja*” që ajo pret është vetë vdekja, e cila nuk i bën më përshtypje, pasi shpirti i saj ka mote që ka humbur.

2 pikë Nëse shpjegon **qartë** nëntekstin e fjalëve përmbyllëse dhe detajin e syve.

1 pikë Nëse shpjegon **pjesërisht** nëntekstin e fjalëve përmbyllëse dhe detajin e syve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Kërkesa 11 2 pikë

Model përgjigjeje

Fjalë të prejardhura: *hijshme, pjekun, përhidhej, heshtazi, thellohej, gjarpnue, patrazuem, përflakët, këputka, paurti.*

2 pikë Nëse gjen dy fjalë të prejardhura, tipike dialektore.

1 pikë Nëse gjen një fjalë të prejardhur, tipike dialektore.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim, nëse fjalët e gjetura nuk janë tipike dialektore, ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 12 10 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

3 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtjesore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin)
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike
- interpreton në mënyrë analitike pjesën
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: STRUKTURA E ESESË

1 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

KRITERI III: PASURIA GJUHËSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore dhe fjalëformimi

KRITERI IV: LARMIA SINTAKSORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- zotëron sintaksën
- ka aftësi për të ndërtuar fjali që janë të sakta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja sintaksore

KRITERI V: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore
- përdor si duhet shkronjën e madhe
- përdor si duhet shenjat e pikësimit

PJESA II

ESKILI – Koeforet

Kërkesa 13	D	1 pikë
Kërkesa 14	A	1 pikë
Kërkesa 15	B	1 pikë
Kërkesa 16	B	1 pikë
Kërkesa 17	A	1 pikë

Kërkesa 18 **1 pikë**

Model përgjigjeje

Tufa e flokëve mbi varr është:

1. blatimi i perëndisë që ushqen rininë (Inakun), për të siguruar mbështetjen e kësaj perëndie në hakmarrjen e tij që kërkon energji e forcë.

Ose

2. krijim i urave të komunikimit me botën e të vdekurve, përmes sinjalit të flokëve mbi varr, përpjekje për të kontaktuar me frymën e të atit, si shenjë e rikthimit për hakmarrje.

Ose

Është thjesht shenjë zie për të atin.

1 pikë Nëse shkruan një nga arsyet e mësipërme.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 19 **2 pikë**

1 pikë Kjo skenë zhvillohet në një mjedis të përzishëm, pranë varreve dhe ende nuk ka aguar (koha). E gjitha kjo shkakton një atmosferë *vetmie, heshtjeje, trishtimi, frike, ankthi, faji*.

1 pikë Detajet: *varr, që me natë, gra të përzishme, përmbi varr, nata, tabuti, vdekja, zija, gjëma, vula e trishtimit, marrja e gjakut, profecia, kobi, hija e zezë. (Nxënësi duhet të përmendë të paktën tri nga këto detaje.)*

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

Kërkesa 20 2 pikë

- 1 pikë** Kori është në pozicionin e një aktori.
- 1 pikë** Nëpërmjet korit dramaturgu shpreh idetë e tij dhe ilustron temat dhe motivet më të rëndësishme të tragjedisë. Në këtë mënyrë roli i tij është tepër aktiv në skenë, në mbështetje ose jo të aksionit, mendimeve, gjendjeve apo fjalës së personazheve.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 21 2 pikë

- 1 pikë** E veçanta është rendi i përmbysur i gjymtyrëve.
- 1 pikë** Inversioni që përftohet në këtë rast krijon një përfytyrim më konkret emocional të pamjes që theksohet në dy fjalë: *përzishëm* dhe *pikëllueshëm*. Kjo e jep më të qartë tablonë e përzishme që sundon, pasi e fokuson vëmendjen e lexuesit në mënyrën e lëvizjes dhe të veshjes së personazheve, të cilat ndikojnë në tragjizmin e situatës.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 22 2 pikë

- 1 pikë** Ëndrra ogurzezë, që ka parë, e shqetëson Klitemnestrën. E ndikuar nga profecia, ajo ka frikë nga hakmarrja e mundshme që mund të kërkojë i shoqi i vrarë barbarisht prej saj.
- 1 pikë** Rrjedhohat janë: Gratë janë detyruar që me natë të çojnë blatime te varri dhe të kryejnë ritet për të vdekurit, për të lehtësuar shpirtin e të vdekurit dhe të të gjallëve.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 23 4 pikë

Model përgjigjeje

Detajet që tregojnë afri janë:

*goditja e gjoksit me grushte,
çjerrja e faqeve,
grisja e rrobave,
qarja në grup.*

Interpretimi: Shikojmë disa pika afrimi midis vajeve shqiptare dhe atyre greke. Është i njëjti rit i të vajtuarit, i ngjashëm me kodet zakonore veriore të vajit, dhe me “gjamën” e burrave. Ata shkulin flokët, gërvishtnin fytyrën me thonj dhe i binin gjoksit me grushte, rrethrotullohen dhe qajnë në grup.

- 3 pikë** Nëse shkruan tri nga detajet e mësipërme.
- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga detajet e mësipërme.
- 1 pikë** Nëse shkruan një nga detajet e mësipërme.
- 1 pikë** Nëse interpreton shkurt thelbin e kësaj afrie.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim (detaje që nuk kanë lidhje) ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 24 2 pikë

- 1 pikë** ëndërrshpjeguesit (fjalë tipike e përbërë e krijuar nga Kadare)
- 1 pikë** ëndërr+ shpjegues
- 0 pikë** Nëse gjen fjalë që nuk janë krijim tipik i Kadaresë, nëse nuk shpjegon mënyrën e formimit ose nuk përgjigjet fare.